| Syllabus | |
|---|---|
| | |
| **Njësia akademike:** | **Fakulteti Juridik – Universiteti i Prishtinës** |
| **Titulli i lëndës:** | **E DREJTA PENALE** |
| **Niveli:** | **Bachelor** |
| **Statusi lëndës:** | **Obligative** |
| **Viti i studimeve:** | **Viti II, semestri III** |
| **Numri i orëve në javë:** | **3** |
| **Vlera në kredi – ECTS:** | **7** |
| **Koha / lokacioni:** | |
| **Profesori i lëndës:** | ***Prof.Ass.Dr.* Avni Puka**<br>***Dr.sc.Nita Shala*** |
| **Detajet kontaktuese:** | *avni.puka@uni-pr.edu*<br>*nita.shala@uni-pr.edu* |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës** | Lënda e së drejtës penale (Pjesa e përgjithshme) që ligjërohet në këtë semestër përmban:<br><br>- Hyrje në të drejtën penale (nocioni, lënda dhe funksioni i saj). Kuptimi i së drejtës penale si degë e legjislacionit pozitiv dhe si shkencë e së drejtës.<br>- Njohuri të përgjithshme për legjislacionin penal dhe mbi kuptimin e strukturës së kodit penal.<br>- Parimet e përgjithshme, nocioni i veprës penale, përgjegjësisë penale dhe instituteve tjera të përgjithshme të së drejtës penale.<br>- Nocioni, funksioni dhe sistemi i sanksioneve penale. |
| **Qëllimet e lëndës:** | Qëllimi i studimit të kësaj lënde është që tu ofrojë studentëve të nivelit të studimeve themelore - *bachelor* njohuri themelore dhe të mjaftueshme lidhur me parimet dhe institutet kryesore të së drejtës penale, përkatësisht pjesën e përgjithshme të saj. |
| **Rezultatet e pritura të nxënies:** | Pas përfundimit të studimit të kësaj lënde, pritet që studentët:<br><br>- Të jenë në gjendje të konceptojnë saktë se çka studion e drejta penale (Pjesa e përgjithshme) dhe të njohin institutet e përgjithshme të saj.<br>- Të kuptojnë me saktësi nocionin e veprës penale (*si dhe elementët themelore të saj*), përgjegjësisë penale dhe instituteve tjera, të kuptojnë sistemin e |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | sanksioneve penale dhe të kenë aftësi që të interpretojnë normat penale-juridike.<br>- Të kuptojnë se fenomeni dinamik dhe kompleks i kriminalitetit është një nga problemet me aktuale dhe preokupuse për shoqërinë bashkëkohore.<br>- Të njohin bazën juridike për trajtimin e kryesve të veprave, duke iu qasur analizës së dispozitave juridike pozitive (*de lege lata*) dhe duke marrë parasysh nevojën për plotësim dhe ndryshim të legjislacionit nga kjo fushë (*de lege ferenda*). | | |
| | | | |
| **Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)** | | | |
| **Aktiviteti** | **Orë** | **Ditë/javë** | **Gjithësej** |
| Ligjërata | 3 | 15 | 45 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 1 | 15 | 15 |
| Punë praktike | / | / | / |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 1 | 15 | 15 |
| Ushtrime në teren | / | / | / |
| Kollokfiume,seminare | 1 | 2 | 2 |
| Detyra të shtëpisë | / | / | / |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | / | / | / |
| Përgaditja përfundimtare për provim | / | / | / |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | 3 | 3 | 9 |
| Projektet,prezentimet ,etj | 1 | 15 | 15 |
| **Totali** | | | **101** |
| **Metodologjia e mësimëdhënies:** | 1. **Metoda e mësimdhënies aktive.**<br>2. **Metoda e mësimdhënies inter-aktive.**<br>3. **Metoda krahasuese.**<br>4. **Metoda e analizës.**<br>5. **Metoda e studimit të rasteve**. | | |
| **Metodat e vlerësimit:** | *Për vlerësimin definitiv të studentëve nga lënda e Drejta Penale do të marren parasysh format e fitimit të pikëve të shprehura në përqindje si vijon:*<br>Vlerësimi intermediar............................................25%<br>Punimi seminarik i mbrojtur publikisht................. 15% | | |

| | |
|---|---|
| | Prezantimi ..............................................................10%<br>Vijimi i rregullt dhe pjesëmarrja aktive.....................5%<br>Provimi final...........................................................45%<br>Totali.....................................................................100% |

**Përshkrimi i sistemit të notimit:**

| Nota | ECTS nota | Pike | Përkufizimi |
|---|---|---|---|
| 10 | A | 91–100 % | **SHKËLQYESHËM**- njohuri të shkëlq.me vetëm disa gabime minore |
| 9 | B | 81 – 90 % | **SHUMË MIRË** – mbi mesatare standarde,por me disa gabime |
| 8 | C | 71 – 80 % | **MIRË** – rezultat në përgjithësi i mire me disa gabime që vërehen |
| 7 | D | 61 – 70 % | **KËNAQSHËM** – mire,por me mjaft gabime |
| 6 | E | 51 – 60 % | **MJAFTON** – rezultatet plotësojnë kriteret minimale |
| 5* | FX | 40 – 50 % | **DOBËT**– kërkohet edhe pak punë nga studenti për të fituar kreditë |
| 5 | F | 00 - 39 % | **DOBËT** – kërkohet shumë punë për të fituar kredi |

**Literatura**

| | |
|---|---|
| **Literatura bazë:** | - Salihu, I: E Drejta Penale - Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2015.<br>- Puka, A: E Drejta Penale - HYRJE NË SISTEMIN LIGJOR TË KOSOVËS, Prishtinë, 2019, fq.270-308 (*http://jus.igjk.rks-gov.net/787/*).<br>- Kodi Penal i Republikës së Kosovës, 2019.<br>- Ligjërata të autorizuara të mësimdhënësit. |
| **Literatura e rekomanduar:** | - Puka, A: E Drejta Penale, FJALOR JURIDIK (E drejta private - E drejta publike – e drejta penale), Prishtinë, 2019, fq.235- 320 (*http://jus.igjk.rks-gov.net/786/*).<br>- Antolisei, F.: Diritto penale (Parte generale), Milano, 2008.<br>- Beltrani, S., Caringella, F., Marino, R.: Codice Penale Commentato, 1996.<br>- Bohlander, M.: Principles of German Criminal Law, Studies in International & Comparative Criminal Law, Oxford, 2009.<br>- Cadoppi, Alberto: Introduzione allo studio del diritto penale comparato, CEDAM, 2004.<br>- Dolcini, E., Gatta, G.L.: Codice Penale Commentato, 2015.<br>- Elezi, I., Kacupi, S., Haxhia, M.: Komentari i Kodit Penal të R. së Shqipërisë, Tiranë, 1999. |

| | |
|---|---|
| | - Elezi, S. Kacupi dhe M. Haxhia, Komentari i Kodit Penal të R. së Shqipërisë, Tiranë, 1999.<br>- Fiandaca, G., Musco, E.: Diritto Penale (Parte generale), Bologna, 2019.<br>- Fiore, C., Fiore, S.: Manuale di diritto penale. Parte generale, Wolters Kluver, 2020.<br>- Fletcher, G.P.: Basic Concepts of Criminal Law, Oxford, 1998.<br>- Francoise, T., Kerchove, V.D.: : Introduction au droit penal, Bruksel, 1999.<br>- Heller, K. J & Dubber M.D. The Handbook of Comparative Criminal Law. Stanford University Press, 2011.<br>- International Review of Penal Law/ Revue Internationale de Droit Penal (AIDP/IAPL).<br>- International Review of Penal Law/ Revue Internationale de Droit Penal.<br>- Jerome Hall: General Principles of Criminal Law, New Jersey, 2005.<br>- Joshua. D.: Understanding criminal law, Second edition, New York, 1995.<br>- Kambovski, V.: E Drejta Penale – Pjesa e përgjithshme, Shkup, 2006.<br>- Marinucci, G., Dolcini, E. Gatta, G.L.: Manuale di Diritto Penale – Parte Generale, Giuffrè F.L., 2020.<br>- Padovani,T.: Teorie della colpevolezza e scopi della pena, Rivista italiana di diritto e procedura penale, 1987.<br>- Palazzo, Francesco & Papa Michele: Lezioni di diritto penale comparato, Giappichelli, 2013.<br>- Pradel. J. : Droit Penal General, Paris, 2000.<br>- Pradel. J., Geert Corstens, G., Vermeulen, G.: E drejta penale Evropiane/ Përkthim shqip, Paris, 2009.<br>- Ramacci, F.: Corso di diritto penale, Torino, 2008.<br>- Roger Geary : Understanding Criminal Law, London , 2002.<br>- Roxin, C.: Sul problema del diritto penale della colpevolezza, Rivista italiana di diritto e procedura penale, 1984<br>- Salihu,I.,Zhitia,H.,Hasani,F.: Komentar-Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Prishtinë 2014<br>- Ukaj, B.: Denimet në të drejten penale të Shqipërisë, Prishtinë, 2006.<br>- Kodi i Drejtësisë për të Mitur i Kosovës, Prishtinë, 2018. |

| Ligjëratat | |
|---|---|
| **Java** | **Tema** |
| Java I | - Përkufizimi, lënda, karakteristikat dhe funksioni i së drejtës penale<br>- Raporti së drejtës penale me disiplinat tjera të së drejtës<br>- Shkenca e së drejtës penale dhe raportet e saj me shkencat tjera penale<br>- Specifikat e së drejtës penale, ndarja dhe autonomia e saj<br>- Historiku i së drejtës penale dhe shkollat kryesore. |
| Java II | - Burimet e së drejtës penale<br>- Përkufizimi i ligjit penal, kodit penal dhe legjislacionit penal<br>- Parimi i ligjshmërisë apo legalitetit (Nullum crimen, nulla poena sine lege) dhe nënparimet e tij<br>- Parimi i fajësisë (Nullum crimen, nulla poena sine culpa)<br>- Parimi i humanitetit<br>- Parimi i individualizimit |
| Java III | - Interpretimi i normës juridike - penale (Llojet e interpretimit)<br>- Veprimi i ligjit penal në kohë, në hapësirë dhe ndaj personave<br>- Parimi territorial<br>- Parimet e zbatimit të legjislacionit penal për veprat penale të kryera jashtë territorit të shtetit<br>- Vendi dhe koha e kryerjes së veprës penale<br>- Ekstradimi dhe e drejta e azilit |
| Java IV | - Vepra penale – përkufizimi dhe elementet e saj<br>- Teoria e përgjithshme e veprës penale - teoritë në lidhje me ndarjet e elementeve themelore të veprës penale<br>- Ndarja e veprave penale<br>- Figura e veprës penale, përkufizimi dhe llojet e saj,<br>- Objekti dhe subjektet e veprës penale<br>- Lidhja shkakore apo kauzale |
| Java V | - Përgjegjësia penale<br>- Përgjegjshmëria – aftësia për faj<br>- Aftësia e zvogëluar mendore<br>- Fajësia (përkufizimi dhe format)<br>- Dashja<br>- Pakujdesia<br>- *Actiones liberae in causa* |
| Java VI | - Shkaqet (bazat) e përjashtimit të kundërligjshmërisë<br>○ Sipas pjesës së përgjithshme të Kodit Penal<br>○ Sipas pjesës së posaçme të Kodit Penal<br>○ Sipas bazave tjera |
| Java VII | - Fazat e kryerjes së veprës penale (vendimi për kryerjen e veprës penale, veprimet përgatitore, tentativa e veprës penale, |

| | |
|---|---|
| | heqja dorë vullnetare nga veprimet përgatitore dhe tentativa e veprës penale, kryerja e veprës penale)<br>- Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale (bashkëkryerja, ndihma, shtytja dhe bashkimi kriminal)<br>- Përgjegjësia penale e bashkëpunëtorëve në kryerjen e veprës penale<br><br>**Vlerësimi i parë.** |
| Java VIII | - Bashkimi i veprave penale (llojet)<br>- Bashkimi fiktiv ideal dhe format e tij<br>- Bashkimi fiktiv real dhe format e tij<br>- Lajthimi në të drejtën penale dhe format e tij |
| Java IX | - Pasojat juridike të veprës penale<br>- Sanksionet penale (përkufizimi dhe karakteristikat)<br>- Dënimet (përkufizimi, elementet dhe karakteristikat e dënimit)<br>- Baza juridike e dënimit<br>- **Qëllimi i dënimit**<br>- Llojet e sanksioneve penale<br>- Dënimet kryesore |
| Java X | - Matja e dënimit (përkufizimi i dënimit, llojet dhe nënllojet e matjes se dënimit).<br>- Matja e dënimit për veprat penale në bashkim, personit të dënuar dhe recidivistëve.<br>- Paraburgimi dhe llogaritja e tij në dënim<br>- Individualizimi i dënimit<br>- Rrethanat lehtësuese dhe rënduese<br>- Zbutja e dënimit, lirimi nga dënimi dhe baza e veçantë e lirimit nga dënimi |
| Java XI | - Dënimet alternative (përkufizimi, qëllimi dhe llojet).<br>- Dënimi me kusht dhe revokimi i tij<br>- Dënimi me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm.<br>- Dënimi me kusht me urdhër të shërbimit sprovues.<br>- Dënimi me kusht me urdhër për punë në dobi të përgjithshme<br>- Gjysëmliria<br>- Përkufizimi i vërejtjes gjyqësore dhe kushtet për shqiptimin e këtij sanksioni penal |
| Java XII | - Dënimet plotësuese (përkufizimi, qëllimi dhe llojet).<br>- Lirimi me kusht<br>- Masat e trajtimit të detyrueshëm,<br>- Marrja e interesit pasuror të fituar me vepër penale.<br>- Rehabilitimi dhe llojet e tij<br>- Shlyerja e dënimit<br>- Zbulimi i të dhënave nga dosja |

| | |
|---|---|
| Java XIII | - Shuarja e dënimit<br>- Parashkrimi<br>  o Parashkrimi i ndjekjes penale<br>  o Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit<br>- Mos parashkrimi i veprave penale |
| Java XIV | - Falja<br>- Amnistia<br><br>***Vlerësimi i dytë.*** |
| Java XV | - E drejta penale për të mitur<br>- Masat dhe dënimet ndaj të miturve (kryes të veprave penale) |

**Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

- Nga studentët kërkohet që të jenë të rregullt në ligjërata dhe inkurajohen të jenë aktiv me pyetje dhe diskutime rreth tematikave të lëndës.
- Pjesëmarrja në ligjërata është e detyrueshme dhe shumë e rëndësishme për të realizuar qëllimin e lëndës/programit.
- Ligjëratat dhe vlerësimi do të jetë në pajtim me programin dhe informimin paraprak të studentëve.
- Sjellja në pajtim me rregulloren dhe standardet etike të përcaktuara nga universiteti. Studentët dhe mësimdhënësit duhet të ruajnë standardet më të larta të ndershmërisë dhe integritetit akademik.